



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA**



V E N D I M

Nr. 29, datë 28.09.2011

PER PËRCAKTIMIN E LLOGARITJES SË SASISË SË UJRAVE TË NDOTURA

Në zbatim nenit 14, nenit 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Sasia e ujrave të ndotura për çdo konsumator do të llogaritet 100% e sasisë së ujit të pijshëm të përdorur, sipas “Metodologjisë për vendosjen e tarifave”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim nr. 28, datë 28.09.2011
2. Vendimi i KKRr, nr.48, datë 24.01.2000, për “Përcaktimin e sasisë së ujrave të shkarkuar”, shfuqizohet;
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.11.2011

**KRYETARI
Avni Dervishi**